



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT

Raport për rezultatet e konsultimit publik

1. Titulli i projekt aktit

Projektvendimi “Për rregullat e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje për planet, programet, strategjitë dhe projektaktet normative në fushën e mjedisit”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Hartimi i këtij projektvendimi u realizua nga struktura përgjegjëse për konsultimin e publikut në vendimmarrjen mjedisore në Ministrinë e Mjedisit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Programimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, si dhe drejtoritë teknike në fushën e mjedisit.

Projektvendimi “Për rregullat e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje për planet, programet, strategjitë dhe projektaktet normative në fushën e mjedisit” iu nënshtrua procesit të konsultimit publik përmes publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJKP), në periudhën nga data 11.2.2026 deri më 11.3.2026.

Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 431 shikime në platformë, por nuk janë paraqitur komente në RENJKP.

3. Metodat e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi

konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për këtë projektvendim ishin:

- Publikimi në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik (RENJKP);
- Konsultime të zhvilluara në Ministrinë e Mjedisit me pjesëmarrës si: organizata jofitimprurëse, shoqata mjedisore, Zyra për Mjedisin dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm (ESDO), përfaqësues të shoqërisë “Iliria”, zyra e mjedisit, Bashkia Elbasan; përfaqësues të Universitetit “Metropolitan Tirana; gazetarë. Takimi u zhvillua në datë 6.3.2026.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët që shprehën interes dhe kontribuuan me komente për projektvendimin, janë:

- Shoqata mjedisore: Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA);
- Zyra për Mjedisin dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm (ESDO);
- Përfaqësues të shoqërisë “Iliria”;
- Zyra e mjedisit, Bashkia Elbasan;
- Përfaqësues të Universitetit “Metropolitan Tirana;
- Gazetar

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Transparenca e procesit pas përfundimit të konsultimit publik	Në nenin 20 të përfshihet detyrimi për të pasqyruar në relacionin e dëgjësës publike sugjerimet dhe vërejtjet që nuk janë pranuar, së bashku me arsyetimin përkatës.	Arben Burda(pedagog og Metropolis); Zydjon Vorpsi (PPNEA); Lorena Haxhiymeri (Bashkia Elbasan); Abdulla Diku (ekspert mjedisor)	Pranuar	U reflektua në nenet 19 dhe 20, duke parashikuar dërgimin e materialit përmbledhës të komenteve dhe publikimin e tyre së bashku me arsyetimin përkatës.
Referencat në bazën ligjore	U propozua shtimi si referencë ligjore edhe i pikave 7 dhe 8 të Konventës së Aarhusit.	Artan Rama gazetar	Refuzuar	Referimi në pikën 1 të nenit 3 të Konventës është konsideruar i mjaftueshëm, pasi ajo parashikon detyrimin për marrjen e masave ligjore dhe rregullatore për garantimin e informimit, pjesëmarrjes së publikut dhe aksesit në drejtësi. Në këtë

				kuadër, projekt-VKM-ja synon të krijojë një kuadër të qartë dhe të qëndrueshëm për zbatimin e këtyre parimeve.
Shtimi i fushave të strategjive planeve dhe programeve që do të nënshtroheshin procesit të pjesëmarrjes publike	Komenti ishte: “Vlerësoj, se krahas strategjive (a, b, c, d, e, f, g), të shtohen edhe strategji të tjera, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis, të tilla si: strategjitë dhe planet në fushën e energjisë; strategjitë dhe planet në fushën minerare; strategjitë dhe planet në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural; strategjitë dhe planet e peshkimit; strategjitë dhe planet për menaxhimin e integruar të bregdetit; strategjitë dhe	Artan Rama, gazetar	Refuzuar	Strategjitë dhe planet në fusha të tilla si energjia, industria minerare, bujqësia, peshkimi apo menaxhimi i bregdetit, të cilat mund të kenë ndikim në mjedis, i nënshtrohen procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedor (VSM), sipas legjislacionit përkatës. Konkretisht, neni 2 i ligjit nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedor”, i ndryshuar, parashikon që planet dhe programet në sektorë si bujqësia, pyjet, peshkimi, energjia, industria, industria minerare, transporti, menaxhimi i mbetjeve, menaxhimi i ujërave, telekomunikacioni dhe turizmi t’i nënshtrohen këtij procesi. Për rrjedhojë, këto dokumente strategjike trajtohen nëpërmjet një procedure të veçantë të përcaktuar në legjislacionin përkatës.

	planet për bujqësinë, si edhe të tjera strategji/plane/ programe që mund të identifikohen.			
Koment për njoftimin e publikut mbi aktet që po konsultohen	Të krijohet një mundësi teknike (vendosja e një pop-up menu) në faqen e dedikuar të njoftimit të autoritetit publik (përveç regjistrimit të konsultimit të MD) ku “publiku i interesuar” të mund të regjistrojë adresën e e-mail-it, në këmbim të marrjes proaktive të çdo njoftimi, por pa qënë nevoja që të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme faqen e ministrisë për njoftime të reja. Në këtë kuptim, “paragrafi b”,	Artan Rama, gazetar	Pranuar	

	të mund të qartësohet, ndoshta duke përmendur konkretisht regjistrimin e propozuar më sipër.			
Forma e shprehjes së komenteve mund të jetë dhe pa pjesëmarrje në takimet me publikun	Sugjerime të shihet mundësia të shtohet një paragraf, ku “publiku i interesuar” të adresojë komentet lidhur me projektaktin, pa qënë i detyruar të paraqitet në konsultim. Pra, kjo gjë të thuhet konkretisht në projektakt. Mund të shkruhet si përgjegjësi e koordinatorit (i konsultimit publik/i të drejtës së informimit, pra të jepet edhe adresa e tyre, ose adresa info@ e ministrisë)	Artan Rama, gazetar	Pranuar	Në projektakt është parashikuar shprehimisht që publiku mund të paraqesë komente dhe sugjerime për projektaktin edhe pa qënë i pranishëm në takimet publike. Gjithashtu, është përcaktuar që komentet e paraqitura nëpërmjet Regjistrimit Elektronik të Konsultimit Publik ose mjeteve të tjera elektronike konsiderohen njësoj të vlefshme si ato të paraqitura në forma të tjera pjesëmarrjeje, si dhe që materiali përmbledhës i komenteve dhe sugjerimeve t’u dërgohet personave që kanë paraqitur komente brenda 6 ditëve pune nga përfundimi i procesit të konsultimit publik.

<p>Për fushën e përgjegjësisë së strukturave që ndërthuren me mjedisin</p>	<p>Projektaktet normative me ndikim në mjedis mund të dalin edhe nga ministri të tjera. Nëse efekti i këtij kreu shihet i lidhur vetëm me Ministrinë e Mjedisit, ministritë mund të çmobilizojnë dhe mund të shpërfillin njoftimet lidhur me projektaktet në fjalë. Le të shihet mundësia e koordinimit mes ministrive në mënyrë që të mos mungojë asnjë njoftim, edhe nëse vjen nga ministritë e tjera dhe se të gjitha njoftimet mbi projektaktet me ndikim në mjedis t'i nënshtrohen së njëjtës procedurë.</p>	<p>Artan Rama, gazetar</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Në nenin 15. Është parashikuar që Ministria përgjegjëse për fushën e mjedisit, së bashku me çdo institucion tjetër përgjegjës për hartimin e akteve normative me ndikim në mjedis, ndërmer hapat e nevojshëm për të siguruar pjesëmarrjen e publikut. Kjo parashikon koordinim ndërministror, në mënyrë që të gjithë aktet normative me ndikim në mjedis t'i nënshtrohen së njëjtës procedurë të konsultimit publik.</p>
<p>Titulli i projektvendimit</p>	<p>Sugjerohet rishikimi i terminologjisë</p>	<p>Lorena Haxhiymeri</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Emërtimi i aktit është rishikuar dhe zëvendësuar me “Për</p>

	<p>“tërheqja e publikut”, duke e zëvendësuar me “pjesëmarrja e publikut” ose “njoftimi dhe konsultimi publik”, në përputhje me terminologjinë e legjislacionit përkatës dhe frymën e Konventës së Aarhusit.</p>	Bashkia Elbasan		<p>miratimin e rregullave të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje për planet, programet, strategjitë dhe projektaktet normative në fushën e mjedisit”, në përputhje me terminologjinë e legjislacionit përkatës dhe frymën e Konventës së Aarhusit.</p>
	<p>Afati i konsultimit për projektaktet normative Rekomandohet që afati minimal për paraqitjen e komenteve të mos jetë më pak se 20 ditë kalendarike, në përputhje me legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik.</p>	Lorena Haxhiymeri Bashkia Elbasan	Pranuar	<p>Afati për paraqitjen e komenteve nga publiku është përcaktuar të jetë jo më pak se 20 ditë pune nga data e njoftimit për fillimin e procesit të konsultimit publik, në përputhje me legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik.</p>
Parashikimi për plane emergjente	<p>Propozohet parashikimi i një dispozite të posaçme për</p>	Lorena Haxhiymeri Bashkia Elbasan	Refuzuar	<p>Direktiva që përafrojmë si dhe Konventa e Aarhusit janë parashikuar</p>

	<p>raste të justifikuara urgjente, me detyrim arsyetimi dhe publikimi, duke garantuar njëkohësisht mundësinë reale për paraqitjen e komenteve nga publiku</p>			<p>specifikisht se cilat mund të kenë procedurë që nuk parashikon tërheqjen e mendimit të publikut dhe Për rastet që kërkojnë vendimmarrje të shpejtë, si planet e emergjencës civile, është parashikuar trajtimi i tyre në nenin 5, pika b) të vendimit.</p>
<p>Për afatet e ankimit</p>	<p>Sugjerohet që afati i ankimit të referojë tek afatet e parashikuara nga legjislacioni përkatës për procedurat administrative dhe gjyqësore, për të shmangur çdo paqartësi interpretimi dhe konflikt normativ.</p>	<p>Lorena Haxhiymeri Bashkia Elbasan</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Në përputhje me praktikën e teknikës legjislative, në aktin normativ nuk përsëriten afatet për ankimin, por referohen dispozitat e ligjit përkatës që rregullon procedurat administrative dhe gjyqësore. Kjo shmang mbivendosjen dhe çdo paqartësi interpretimi ndërmjet aktit dhe legjislacionit ekzistues.</p>
<p>Forma të zgjeruara të konsultimit publik</p>	<p>Projektakti parashikon konsultimin përmes regjistrit elektronik dhe organizimin e takimeve publike. Për të siguruar një</p>	<p>Anila Aliaj, Drejtore egzekutive e CNVP Office – Tirana.</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Në nenet përkatëse: i. Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile (OJF) – Në nenin 15, pika c), është parashikuar që për grupet specifike të interesit dhe OJF-të, njoftimi dhe</p>

	<p>pjesëmarrje më efektive të publikut, sugjerojmë që të parashikohet gjithashtu: konsultimi i strukturuar me organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e mjedisit dhe biodiversitetit; organizimi i konsultimeve territoriale në zonat ku dokumentet strategjike pritët të kenë ndikim të drejtpërdrejtë; përdorimi i formave shtesë të konsultimit online për të rritur aksesin e publikut.</p>			<p>konsultimi të kryhen nëpërmjet e-mailit ose mjeteve elektronike. Termi “grupet specifike” nënkupton që drejtoria teknike që harton aktin identifikon publikun e interesuar, duke siguruar që organizatat që veprojnë në fushën përkatëse të mjedisit dhe biodiversitetit të ftohen, pa kufizim të listës, duke i lënë mundësi për pjesëmarrje sa më të gjerë.</p> <p>ii. Konsultime territoriale – Në nenin 7, pika c), parashikohet që autoriteti publik duhet të organizojë konsultime territoriale në zonat ku strategjitë, planet dhe programet pritët të kenë ndikim të drejtpërdrejtë mbi komunitetet lokale. Konsultimet zhvillohen në përputhje me dispozitat e këtij vendimi për njoftimin dhe marrjen e mendimeve nga publiku.</p> <p>iii. Forma shtesë të konsultimit online – Procedura e</p>
--	--	--	--	--

				konsultimit për grupet e interesit dhe OJF-të përfshin edhe mjetet elektronike të komunikimit, duke rritur aksesin e publikut pa kufizime.
Afatet Kohore	Për të garantuar një analizë reale të dokumenteve nga publiku dhe ekspertët, sugjerojmë që të përcaktohen më qartë afatet minimale të konsultimit publik, duke rekomanduar: <ul style="list-style-type: none"> • të paktën 30 ditë për projektakte normative; • 45–60 ditë për strategji, plane dhe programe mjedisore. 	Anila Aliaj, Drejtore egzekutive e CNVP Office – Tirana.	Pranuar pjesërisht	Për aktet normative nuk u pranua, pasi afatet janë përshtatur dhe me ligjin e Konsultimit Publik. Për startegjitë është përcaktuar jo më pak se 20 ditë pra ka tolerancë në varësi të kompleksitetit.
Konsultimi për dokumente që lidhen me zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin	Për dokumente që lidhen me ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, sugjerojmë që konsultimi publik të	Anila Aliaj, Drejtore egzekutive e CNVP Office – Tirana.	Pranuar	Në nenin 7 është shtuar pika d), sipas së cilës autoriteti publik duhet të organizojë konsultime territoriale në zonat ku strategjitë, planet dhe programet parashikuara në këtë vendim pritet të kenë ndikim të drejtpërdrejtë mbi

	<p>përfshijë në mënyrë të qartë komunitetet lokale, organizatat mjedisore dhe institucionet kërkimore përkatëse. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për plane menaxhimi të zonave të mbrojtura dhe dokumente strategjike që mund të kenë ndikim në habitatet natyrore dhe speciet e mbrojtura.</p>			<p>komunitetet lokale. Kjo siguron përfshirjen e komuniteteve lokale, organizatave mjedisore dhe institucioneve kërkimore përkatëse, veçanërisht për dokumente që lidhen me ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e zonave të mbrojtur.</p>
<p>Identifikimi dhe përfshirja e publikut të ndikuar</p>	<p>Sugjerojmë që projektakti të përforcojë detyrimin e institucioneve publike për të identifikuar dhe informuar në mënyrë aktive “publikun e ndikuar”, duke përfshirë komunitetet lokale,</p>	<p>Abdulla Diku, ekspert mjedisor</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Në përputhje me Konventën e Aarhusit dhe legjislacionin përkatës, për plane, programe, strategji dhe aktet normative, përdoret termi i përgjithshëm “publik”, i cili përfshin çdo individ ose subjekt të interesuar në procesin e konsultimit. Termi “publik i ndikuar” aplikohet vetëm në</p>

	<p>organizatat mjedisore dhe përdoruesit e burimeve natyrore që mund të preken nga vendimmarrja.</p>			<p>rastet e aktiviteve specifike me ndikim të drejtpërdrejtë mbi mjedisin, të cilat trajtohen në procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM). Prandaj, në këtë draft-VKM nuk aplikohet termi “publik i ndikuar”, për të ruajtur përputhshmërinë ligjore dhe qartësinë e procedurës.</p>
<p>Koment mbi shtimin e shtojcave në projektvendim</p>	<p>VKM duhet të ketë shtojcat për: Formën e njoftimit (elektronik, të printuar, portalin e dedikuar për degjësat, formatin e njoftimit, titullin, madhësinë e shkrimit, llojin e shkrimit etj. Formatin e procesit të degjësës publike (lista e pjesëmarrjes, problematika e adresuar nga grupet e</p>	<p>Abdulla Diku, ekspert mjedisor</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Draft-VKM përfshin planet, programet, strategjitë dhe aktet normative, ku qëllimi është të sigurohet pjesëmarrje sa më e gjerë e publikut dhe grupeve të interesit, kryesisht në këto takime vijnë pjesarë të shoqatave mjedisore dhe lista e prezencës është pjesë e dokumentimit të takimit. Për aktivitetet që kërkojnë Vlerësim të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe ku ka një publik të ndikuar direkt, legjislacioni parashikon formalitete më të hollësishme: lista pjesëmarrësish</p>

	<p>interesit, argumentimi teknik dhe reflektimi i vërejtjeve, krahasimi analitik i versionit të parë dhe atij final të dokumentit për të cilin behet degjese etj)</p> <p>Shtojca për marrjen dhe ruajtjen e të dhënave të personave pjesëmarrës në degjese (ID, fotot, kontaktet, konfidencialitetin etj).</p>			<p>me ID, fotografi, ruajtjen e të dhënave dhe procesverbal me minutat e takimit. Për këtë draft, këto detaje nuk janë të nevojshme, pasi procesi fokusohet në komentimin e gjerë nga publiku i interesuar, duke përdorur regjistrin elektronik dhe forma të tjera të komunikimit.</p>
<p>Përgjegjësia për mosrealizimin e procesit të pjesëmarrjes së publikut.</p>	<p>Duhet përcaktuar penaltetet për autoritetin publik që nuk realizon degjese sipas kushteve të VKM. duhet sqaruar nëse një dokument i dale nga një proces i parregullt</p>	<p>Abdulla Diku, ekspert mjedisor</p>	<p>Pranuar</p>	<p>Çështjet që lidhen me përgjegjësinë e autoriteteve publike për zbatimin e procedurave të konsultimit publik dhe pasojat në rast mosrespektimi trajtohen në Kreun IV të VKM-së, ku përcaktohen dispozitat përkatëse për zbatimin dhe përgjegjësitë e autoriteteve publike.</p>

	degjese publike vlen apo jo Kush dhe cfare përgjegjësie mbahet nëse autoriteti nuk realizon dëgjesen.			
--	--	--	--	--